



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

14-020/04-60607/18 më 13. 03. 2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 28/2008, të nenit 7, paragrafit 1 pika 1.4 të Rregullores 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, Strategjisë nacionale për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. Nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË KOMUNËN E PRISHTINËS

- I. Formohet Grupi Punues për hartimin e Planit lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Prishtinës, në këtë përbërje:
1. Lulzim Vrapca, kryesues,
 2. Klaudia Mula, anëtare,
 3. Ajshe Bërveniku, anëtare,
 4. Hyzri Bunjaku, anëtar,
 5. Vebi Mujku, anëtar,
 6. Nazim Cakolli, anëtar,
 7. Eroll Raskova, anëtar,
 8. Igballe Përcuki Tahiri, anëtare,
 9. Premtime Preniqi, anëtare,
 10. Idriz Berisha, anëtar,
 11. Adnan Ajeti, anëtar,
 12. Luaras Oseku, anëtare,
 13. Arbnora Froku, anëtare,
 14. Alban Kryeziu, anëtar,
 15. Florim Bajrami, anëtar.
- II. Grupi Punues nga pika I e këtij Vendimi ka për detyrë të hartojë Planin lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Prishtinës, bazuar në obligimet dhe përgjegjësitë që u takojnë drejtorive komunale.
- III. Niveli lokal do të bashkërendojë objektivat strategjike (1. Arsimi, 2. Punësimi dhe mirëqenia sociale, 3. Shëndetësia dhe 4. Banimi) me qëllim të përmirësimit të jetës së

komuniteteve rom dhe ashkali, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe prioritetet komunale përkatëse.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

T'U DËRGOHET,

- Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
 - Anëtarëve të Komisionit;
 - Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS

Shpend Ahmeti